

## KONTRATË SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot, me date 03 . 11 .2021 (dymije e njezete nje),

**SHITESI : Z . Gledis Çekrezi** , shtetas shqiptar, lindur ne Gramsh, me date 18.06.1992, mbajtes i ID me nr J20618094H, me banim ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar. ( ketu e me poshte do te quhet (**SHITESI**)).

Dhe ,

**BLERES : Z. Bujar Zeqiri**, shtetas shqiptar, lindur neKryevideh, Durres, me date 08.06.1985, mbajtes i ID me nr I50608057B me banim ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar .( ketu e me poshte do te quhet "**BLERESI**").


Palet kerkuan dhe rane dakort per hartimin e kesaj Kontrate Shitjesh Kuotash duke u mbeshtetur ne parashikimet e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise si dhe ne Ligjin Nr . 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare" sipas kushteve qe vijojne me poshte:

### Ekzistojne keto kushte paraprake

1. Rezulton se shoqeria "ROZALIO CONSULTING" sh.p.k, eshte person juridik shqiptar regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) me date 10.02.2020 dhe pajisur me numer identikimi NUIS – **M01410008C**, me kapital themeltar prej 1.567.000 (nje milion e peseqind e gjashtedhjte e shtate mije) leke.

Ortaku i Shoqerise "Rozalio Consulting" sh.p.k, eshte:

- i) Z. Gledis Çekrezi i cili zoteron 1 pjese te kapitalit te Shoqerise me vlere 1.567.000 leke (ALL) qe perfaqesojne 100% te kapitalit te Shoqerise;
2. Shoqeria ka si objekt veprimtarie : Objekti i veprimtarise se shoqerise është te ndërrmarrë çdo veprim ose aktivitet tregtar te ligjshem per zhvillimin e te cilave nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te themelohet dhe regjistrohet sipas legjislacionit shqiptar i ndryshuar rast pas rasti duke perfshire por pa u kulizuar ne: Të operoje në sektorin e telekomunikacionit duke kryer çdo lloj veprimtarie nëpërmjet telefonit per llogari të vet apo te të tretëve me seli në Shqiperi apo ne çdo vend tjetër që ka lidhje me Republiken e Shqiperise, duke respektuar ligjin në fuqi. Të kryeje aktivitete nepermjet telefonit te çdo lloji per llogari te vet apo te tretëve, telemarketing, sekretari telefonike, shitje nëpërmjet telefonit, sondazhe, mesazhe promocionale dhe cdo lloj tjetër aktiviteti te lidhur me te pa kufizim. Shoqeria mund te krye gjithashtu te gjitha operacionet tregtare mbi pasuri te



luajtshme apo te paluajtshme që do të vlerësohen të nevojshme ose te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe do te bleje kuota kapitali themeltar te shoqerive te tjera që kane objekt te ngjashem ose te afert me te veten. Shoqeria mund te marrë pjese me cilësinë e ortakut apo aksionerit në shoqeri 2 te tjera tregtare me objekt veprimtarie të njejte apo te ndryshem nga i saj. Shoqeria mund të ofrojë konsulencë ligjore dhe asistencë per personat juridike dhe fizikë, shqiptare apo te huaj, në fushen civile, penale, administrative, tregtare, bankare, shërbime ligjore mbrojtese, perkthime, perfaqesim ligjor dhe veprimtari te tjera te lejuara nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi. Software Development.

3. Ne date 03.11.2021 ortakut i shoqerise "ROZALIO CONSULTING" sh.p.k, ka vendosur shitjen e kuotave me vlere nominale 1.567.000 leke qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise ne favor te Z. Bujar Zeqiri.
4. Nga ky moment, do te largohet Z. Gledis Çekrezi si ortak i shoqerise dhe Shoqeria "ROZALIO CONSULTING" do te kete si ortak te vetem Z. Bujar Zeqiri, qe zoteron 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise me vlere 1.567.000 leke.

## **NENI 1**

### **Objekti I Kontrates**

- 1.1 Objekti i kesaj Kontrate eshte shitja e 1 (nje) pjese te kapitalit themeltar te Shoqerise, me vlere 1.567.000 leke, qe perfaqeson 100% te Kapitalit Themeltar.

## **Neni 2**

### **Cmimi i shitjes**

- 2.1 Palet bien dakort qe cmimi total i shitjes se ketyre kuotave do te jete si me poshte.
- 2.2 Duke nisur nga neni 2 shitesi eshte dakort dhe me vullnet te lire i shet bleresit 1 (nje) pjese te kapitalit themeltar te shoqerise qe eshte e barabarte me vleren e 1.567.000 leke (nje milion e peseqind e gjashtedhete e shtate mije) leke dhe qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te shoqerise. Palet deklaruan se pagimi i cmimit te shitjes eshte kryer plotesisht nga bleresi, sot ne daten e hartimit te kesaj Kontrate dhe jashte zyres prane Qendres Kombetare Te Biznesit (QKB).

## **Neni 3**

### **Kalimi i titullit te pronesise**

- 3.1 Kalimi i titullit dhe pronesise behet nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e rregjistrimit te kalimit , sipas pikes 2 te ketij neni.
- 3.2 Shoqeria regjistrimin e kuotes , sipas nenit 43 te ligjit nr 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" . Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

3.3 Nje kopje e kesaj kontrate shitjeje do te depozitohet menjehere prane Qendres Kombetare Te Biznesit, (QKB) ne menyre qe te behet kalimi i menjehershem i kuotave ne pronesi te bleresit.

#### **Neni 4**

##### **Te Drejtat dhe detyrimet e shitesit**

4.1 Shitesi mori persiper, te njoftoje, garantoje dhe siguroje Bleresin se deri ne momentin e lidhjes dhe te nenshkrimit te Kontrates se mesiperme keto kuota :

- Nuk jane objekt i ndonje konflikti gjyqesor.
- Nuk jane te bllokuara per llogari te te treteve.
- Shitesi eshte pronar ligjor dhe nuk ka persona te tjere te kene pretendime ne lidhje me keto kuota.
- Dokumentacioni i bashkangjitur i kesaj Kontrate , eshte origjinal, ligjor dhe nuk eshte marre ne rruge te kundraligjshme apo fallsifikuar.

#### **Neni 5**

##### **Te drejtat dhe detyrimet e Bleresit**

5.1 Qe nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate, Bleresi do paguaje cdo lloj takse mbi kapitalin qe ai zoteron ne shoqeri, detyrimet ndaj te treteve , shteti etj...

5.2 Bleresi ka te drejte qe te sillet si pronar i ligjshem mbi keto kuota nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate.

5.3 Bleresi angazhohet te mbaje ne emrin e vet kuotat qe do te perfitoje nga kjo kontrate shitje kuotash.

#### **Neni 6**

##### **Zgjidhja e Kontrates**

6.1 Palet nuk mund ta zgjidhin kontrate ne menyre te njeanshme pervec kur kemi mos permbushje te detyrimeve.

6.2 Asnjera nga palet nuk ka te drejte te beje ndryshime ne kontrate ne menyre te njeanshme. Per cdo problem qe mund te linde, apo ndryshim i domosdoshem i kontrates i diktuar nga kushtet konkrete te vendit apo legjislacionit, palet do te infrmojne njeri tjetrin ne adresat perkatese me shkrim dhe vetem pasi kane rene dakort mund te realizojne ndryshime ne kontrate.

#### **Neni 7**

##### **Interpretimi i Kontrates ne teresi**



7.1 Cdo kusht apo formulim qe mund te sjelle paqartesi do te interpretohet ne kontekstin e teresise se Kontrates dhe ne kendveshtrimin e qellimit qe i shtyu palet te lidhin kete Kontrate.

## **Neni 8**

### **Legjislacioni i zbatueshem dhe juriksioni**

8.1 Kjo kontrate shitje, me objekt Shitje kuotash , eshte hartuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe konkretisht te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise si dhe Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

8.2 Te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve te kesaj Kontrate , jan objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

## **Neni 9**

### **Njoftimet**

9.2 Cdo njoftim, kerkese apo cdo lloj komunikimi nepermjet paleve do te behet me shkrim ne adresat e pershkruara ne kete Kontrate duke patur paraysh qe te dergohet sa me shpejt.

## **Neni 10**

### **Gjuha e Kontrates**

10.1 Kontrata hartohet ne 3 kopje te njejta ne gjuhen shqipe.

**SHITESI**

**Z. GLEDIS ÇEKREZI**

Gledis Çekrezi



**BLERESI**

**Z. BUJAR ZEQRIRI**

Bujar Zeqiri

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Bujar Zeqiri", written over a set of horizontal lines.